

Fillimi > -Kronikë

VIDEO/ Shkodra si Palermo, momenti kur i riu qëllon me breshëri plumbash në furrën e bukës, si degjeneroi sherri në lokal deri në përdorimin e armëve të zjarrit

23 Mars, 2022 09:34



Madhësia e tekstit: - +

Ky është momenti kur 32-vjeçari Armando Ndreu qëllon me armë zjarri në drejtim të furrës së bukës, në lagjen “Skënderbeg”, në pronësi të shtetasit Sadet Sala, me të cilin kishte konfliktuar.

Në pamjet e siguruara për “**BalkanWeb**”, nga gazetari Senad Nikshiqi, shihet se si Ndreu afrohet me qetësi përpara ambienteve të furrës dhe nis të qëllojë me breshëri plumbash në drejtim të saj. Fatmirësisht, veç dëmeve materiale nuk ka pasur persona të lënduar. Sakaq, janë zbuluar dhe motivet që dërguan dy të rinjtë të degjeneronin sherrin deri në përdorimin e armëve të zjarrit. Raportohet se dy të rinjtë, Armando Ndreu dhe Sadet Sala kanë qenë duke pirë së bashku në një lokal. Papritur dy të rinjtë në pije e sipër kanë debatuar me njëri-tjetrin dhe janë konfliktuar. Sadet Sala, pronar i një furre buke në vendin ku pati të shtëna ka goditur me grusht 32 vjeçarin.




Kërko ketu

LAJMET E FUNDIT




Vazhdojnë diskutimet brenda Kryesisë së PD, Bardhi: Të dalim me mesazh për bashkimin e partisë

23 Mars, 2022




Gripi i shpendëve/ Pas ngordhjes së 3 pelikanëve kaçurrel, autoritetet në Korçë dalin në terren, monitorim me dron

23 Mars, 2022




Ndarja nga jeta e Madeleine Albright, Basha mesazh ngushëllim: Mirënjohës për mbështetjen e saj në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë NATO

23 Mars, 2022




"Dyert e hekurit ta shpifin, t'i heqimi", zbardhet debati. Saliqja-Alibeajt: Të mblihdet Këshilli Kombëtar

23 Mars, 2022



"Të fuqishmit dhe i plotfuqishmi", libri i Albright që ia kushtoi luftës në Kosovë: Millosheviç vrau 10 mijë shqiptarë, ja si e ndalëm konfliktin

23 Mars, 2022



Iu gjet vaji kanabisi në bagazh, ylli i basketbollit arrestohet në Rusi

23 Mars, 2022

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb



Ky i fundit ka shkuar në shtëpinë e tij që ndodhet në katin e 7-të të një pallati aty afër duke marrë një automatik kallashnikov dhe është rikthyer duke qëlluar në drejtim të Sadet Salës. Ky i fundit ka arritur që t'i shpëtojë plumbave. Pasi Armando Ndreu ka marrë mjetin e tij për t'u larguar, në atë moment dyshohet se pronari i furrës së bukës Sala ka qëlluar edhe ai me një pistoletë katër here, por edhe 32 vjeçari i ka shpëtuar plumbave. Nga të shtënat një plumb përfundoi brenda furrës së bukës në të cilën ndodhej shitësja e cila shpëtoi mrekullisht bashkë me kalimtarë të tjerë të rastit, banorët e pallateve që kanë shtëpitë aty dhe shitësit e subjekteve të tjera.

Një plumb kapi edhe një mjet të parkuar në anë të rrugës. Dyshohet se 32 vjeçari Ndreu ka qenë në gjendje të dehur kur ka qëlluar. Menjëherë pas ngjarjes së ndodhur policia ka mbërritur aty duke nisur hetimet paraprake. Efektivët kanë identifikuar autorin e dyshuar shtetasin, Armando Ndreu 32 vjeç, banues në lagjen Skenderbeg dhe pronarin e furrës së bukës, shtetasin Sadet Sala. Policia po vijon hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes ndërsa të dy personat e përfshirë në këtë ngjarje janë shpallur në kërkim dhe po punohet për gjetjen dhe kapjen e tyre.

NJOFTIMI I POLICISË MBI NGJARJEN E DJESHME

Rreth orës 19:40, në lagjen “Skënderbeg”, Shkodër, shtetasi A. N., 32 vjeç banues në lagjen “Skënderbeg”, si pasojë e një konflikti për motive të dobëta, me shtetasin S. S., dyshohet se ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të një objekti (furrë buke) në pronësi të shtetasit S. S., duke shkaktuar vetëm dëme materiale.

Shërbimet e Policisë kanë rrethuar zonën dhe vijon krehja e saj, me qëllim kapjen e autorit.

Grupi hetimor ndodhet në vendngjarje dhe nën drejtimin e Prokurorisë vijon punën për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: arme zjarri Ndreu sala sherri Shkoder

TË NGJASHME



EMRI/ I riu qëllon me armë drejt furrës së bukës në Shkodër, policia në kërkim të autorit (VIDEO)

22 Mars, 2022



E dhunuan në sy të gruas, njëri prej vëllezërve të arrestuar tregon pse u konfliktua me kuzhinierin Indrit Çela: I zumë pritë me makinë dhe...

22 Mars, 2022

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË



Aksident në Fushë Krujë Thumanë, përplasen tre automjete, një person bllokohet në makinë

23 Mars, 2022



Gripi i shpendëve/ Pas ngordhjes së 3 pelikanëve kaçurrel, autoritetet në Korçë dalin në terren, monitorim me dron

23 Mars, 2022



I dërgoi kushëritit në burgun e Lushnjes një plumb, policia e arreston në flagrancë

23 Mars, 2022




EMRI/ Kërkohej nga Italia për trafik droge, kush është 45-vjeçari i arrestuar sot në Dibër

23 Mars, 2022



"Strategjia për të kursyer"/? Akset dhe oraret kur do të mungojë energjia, kreu i ARRSH: Janë shmagur zonat ku cenohet siguria rrugore


23 Mars, 2022



Atentati ndaj Inez Hajrulla/ Kërkuan ndryshim të masës së sigurisë, shtyhet gjyqi për 4 të akuzuarit


Enrik Mehmeti | 23 Mars, 2022

KATEGORIA VIDEO




Komisioni i Rithemelitit, Balliu: Kuvendi Kombëtar i 30 prillit do të mbahet. Bashkimi vjen me votë

Osman Stafa | 23 Mars, 2022



"Celulë seksuale" një komedi angleze në Teatrin Eksperimental, Shundi: Jetojmë në shoqëri maskiliste, japim mesazhe

Fatmira Nikolli | 23 Mars, 2022



Atentati ndaj Inez Hajrulla/ Kërkuan ndryshim të masës së sigurisë, shtyhet gjyqi për 4 të akuzuarit

Enrik Mehmeti | 23 Mars, 2022




E ardhmja e PD/ Zheji: Rrezikon të ndahet në tre pjesë, rol kryesor edhe vendimi i gjykatës. Rakiplari: Negociatat për bashkim po ndodhin, momenti që Berisha të mbajë përgjegjësi për...

23 Mars, 2022



Vellaj i jep "Çelësin e Tiranës" ambasadorit të BE-së në mbyllje të deturës, Soreca: Tirana, motori i zhvillimit të vendit

23 Mars, 2022



Skandali/ U përurua në nëntor, ARRSH nuk pyet për krizën e çmimeve, hap gjertër tender për rrugën e Arbrit. Ja sa para do i paguajnë shqiptarët firmës koncesionare 'Gjoka'

23 Mars, 2022



FAQET ZYRTARE

TV News24 Live

News24.al

Radio RASH

PRIVATËSIA

POLITIKA E PRIVATËSISË

KONTAKT

redaksia@balkanweb.com

Alert

Autoktonët

Dola te Ola

Emisioni Vila 24

Fit Station

Frontline

Jeta_pa_filtër

Kjo Javë

Klinika 24

Koha për t'u zgjuar

Me zemër të hapur

Në mëngjes me Klarkun

Në shënjester

Pikat mbi i

Rrugëtim me Anilën

Sport News

Sport News Plus

Fillimi

Shqipëria

Kosova

Rajoni

Sport

Bota

Kulturë

Metropol

Analiza

Teknologji

New York Times

Guardian

WEB BBC

WEB CNN

REUTERS

Washington Post

Times Online

Financial Times

WEB Yahoo

WEB MSN

USA Today